



Në bazë të dispozitave të nenit 40.1 shkronjat (e, ë, t) të Statutit të Komunës së Prishtinës, konform Rregullores nr. 2001/36 mbi shërbimin civil dhe Urdhëresës administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.6.2007, mori

V E N D I M
PËR VAZHDIMIN E KONTRATAVE TË PUNËS
KRYESHEFIT TË EKZEKUTIVIT, ZËV. KRYESHEFIT TË EKZEKUTIVIT
DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

- I. Iu miratohet vazhdimi i kontratave të punës: kryeshefit të Ekzekutivit, zëv. kryeshefit të Ekzekutivit dhe drejtorëve të drejtorive të Komunës së Prishtinës.
- II. Kohëzgjatja e kontratës, së cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet deri më 31.08.2008.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Sektori i punëve të përgjithshme i Drejtoratit të Administratës së Përgjithshme të Komunës së Prishtinës.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.031-334, më 21.06.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri